

Nr. 36 Prot.

Tiranë, 1.07.2024

Lënda: Përgjigje mbi ftesën për bashkëpunim

Drejtuar: **Zotit Fatmir Xhafaj**

Kryetar i Komisionit të Posaçëm “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

Për Dijeni: **Zotit Genci Gjonçaj, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit**

Anëtarëve të Komisionit të Posaçëm “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

I nderuar zoti Xhafaj,

Fillimisht përmes email-it datë 28.06.2024 dhe më pas edhe përmes shkresës zyrtare të Kuvendit me nr. Prot. 2607, datë 28.06.2024 jemi njohur me ftesën për bashkëpunim dërguar shoqërisë civile, përfshirë ISP, lidhur me Komisionit të Posaçëm “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

Në emër të Institutit të Studimeve Politike (ISP) ju falënderojmë për ftesën dhe e konsiderojmë atë tregues pozitiv në drejtim të transparencës. ISP ka qenë dhe është e hapur për bashkëpunim me çdo institucion, sidomos me Kuvendin e RSH, bazuar në parimet dhe përgjegjësitë e shoqërisë civile në një shtet demokratik, në parimet e integritetit dhe të fushës tonë të ekspertizës.

Siç jeni në dijeni, Instituti i Studimeve Politike (ISP) monitoron Kuvendin, përfshirë aktivitetin e deputetëve, vendimmarrjet e Kuvendit dhe aktivitetin e komisioneve të ndryshme. Ne hartojmë dhe publikojmë raporte me gjetjet monitoruese dhe rekomandime, marrim pjesë dhe iniciojmë tryeza pune me Kuvendin lidhur me objektin e monitorimit dhe gjetjet, si dhe në seanca dëgjimore apo aktivitete parlamentare ku kërkohet kontributi i shoqërisë civile bazuar në propozimet/rekomandimet e saj dhe në kërkesat e procesit ligjor të konsultimit publik.

Në pikën VIII të vendimit 50/2024 thuhet “*pranë Komisionit të Posaçëm, për të realizuar një proces sa më gjithëpërfshirës e transparent, do të ngrihet dhe funksionojë grupi i punës i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë me përfaqësues të propozuar nga institucionet e drejtësisë, institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive ligjzbatuese, administrata publike, bota akademike, universitetet publike dhe jopublike, institute e organizata të shoqërisë civile dhe medias, si edhe organizata të sipërmarrjes, etj. Grupi i ekspertëve do të organizohet në 3 nëngrupe, që do të angazhohen për 3 fushat e objektit të veprimtarisë së këtij komisioni. Ekspertët do të angazhohen në funksion të temave përkatëse, që lidhen me fushat e tyre të veprimtarisë në procesin e kryerjes së analizës dhe hartimit e Planit Kombëtar të Veprimit, si dhe propozimin e masave përkatëse legjislative e institucionale. Numri dhe përbërja e grupit të ekspertëve miratohet me vendim të komisionit”.*

Lidhur me këtë vendim të pa përfshirë në konsultimin publik as me Regjistrin e organizatave të regjistruara për këtë qëllim në Kuvend, ISP ka shprehur rezervat e veta publike kohë përpara ftesës për bashkëpunim, (shih: <https://isp.com.al/isp-vleresime-dhe-shqetesime-mbi-komisionin-e-posacem-te-ngritur-nga-kuvendi-me-vendim-50-2024/>). Në dy mbledhjet e Komisionit kemi konstatuar se disa nga shqetësimet janë adresuar pjesërisht, por ndërkohë në pikëpamjen tonë mbeten ende paqartësi lidhur me fokusin, qëllimin, strukturën dhe risqet e mbivendojes së mundshme të aktivitetit apo vendimmarrjes së Komisionit.

Në këtë kuadër, ne i mbetemi vlerësimit se detyra klasike e organizatave të shoqërisë civile nuk është atashimi me ekspertë dhe asistencë pranë komisioneve parlamentare, por monitorimi, shprehja e opinioneve, reagimi me vlerësim e sugjerime në rast kërkesë, si dhe adresimi i interesit publik ndaj rasteve të vendimmarrjes në emër të tij.

Për këto arsye thelbësore dhe parimore ISP i përgjigjet zyrtarisht Komisionit se nuk mund të jetë pjesë e asnjë strukture politike, administrative apo teknike në kuadër të Komisionit të Posaçëm dhe as të Kuvendit.

Në çdo rast ju garantojmë se Instituti i Studimeve Politike (ISP) do të jetë i gatshëm të shpreh opinionet e veta nëse ato kërkohen nga Komisioni lidhur me draftet e vendimmarrjes dhe produktet e mundshme ligjore të tij, si dhe do të vijojë të monitorojë nga afër ecurinë e Komisionit dhe të aktivitetit tjetër parlamentar 2024-2025.

Me konsideratë,



Afrim Krasniqi

Drejtor Ekzekutiv

